



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Praktikë Përkthimi (A-B B-A) I

Ngarkesa: 8 kredite, 80 orë seminare

Viti akademik : 2020-2021, Viti III, semestri I

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Bachelor në "Përkthim dhe Interpretim"

Kodi i Etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore: Të pajisë studentët me njohuritë bazë teorike dhe praktike mbi përkthimin me gojë. Të aftësojë studentët për të analizuar dhe zbërthyer tekste sipas niveleve të tyre gjuhësore dhe stilistike. Të nxisë një qasje ndërdisiplinore duke lidhur përkthimin me fusha si stilistika, gramatika dhe leksikologjia

Objektivat specifike lëndore :

1. Të zhvillojë tek studentët aftësinë për të identifikuar dhe interpretuar struktura gjuhësore dhe veçori të stileve funksionale në përkthimin me gojë.
2. Të njohë studentët me teknikat dhe strategjitë bazë të përkthimit simultan dhe konsektiv.
3. Të forcojë përdorimin praktik të njohurive gramatikore, leksikore dhe stilistike në varësi të llojit të tekstit.

Rezultatet e pritshme:

1. Studentët do të jenë të aftë të zbërthejnë dhe interpretojnë tekste të ndryshme për qëllime përkthimi me gojë.
2. Do të aplikojnë teknika përkthimi në mënyrë të saktë dhe funksionale sipas situatës dhe regjistrimit të komunikimit.
3. Do të tregojnë kompetencë të shtuar në ndërthurjen e njohurive nga fusha të ndryshme gjuhësore në procesin e përkthimit me gojë.